



MENTE.AL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 1183 Prot
Ab 06.07.2022

Nr. / Prot

MARRËVESHJE
MBI
“REALIZIMIN E PRAKTIKAVE / INTERSHIPEVE”

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, i cili është autoritet kompetent për qëllimin e Marrëveshjes, përfaqësuar nga Prof. Dr. Spiro Drushku në cilësinë e Dekanit.

dhe

Subjekti **Mente.AL** me **Nipt M215070094 person fizik** përfaqësuar nga **DETION ALIAJ** në cilësinë e Administratorit, në cilësinë e ofruesit të praktikës.

Nisur nga:

Interesi dhe dëshira e mirë e të dy institucioneve për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin me qëllim ofrim për studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës praktikim dhe trajnim sipas nevojave të tregut të punës. Nëpërmjet praktikave dhe trajnimeve profesionale studentët do të krijojnë mundësi për të marrë eksperiencë pune, të zhvillojnë dhe të zgjerojnë dijet e fituara në Fakultet si dhe të afirmohen dhe të rritin mundësitë për punësim. Institucioni që do të ofrojë praktikat ose trajnimin do të krijojë mundësinë e njohjes dhe vlerësimit të kandidatëve për të punësuar në të ardhmen.

Në mbështetje të :

Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” indryshuar dhe Ligjit Nr. 10 171 Datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.

Bien dakort mbi Marrëveshjen si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Kjo Marrëveshje do të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve në realizimin e praktikave/intershipeve.

Neni 2 Kohëzgjatja dhe rinovimi

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për tre vjet nga data e nënshkrimit të saj dhe është e rinovueshme vetëm nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet palëve. Pavarësisht përfundimit të kohëzgjatjes të kësaj Marrëveshjeje, palët impenjohen të përfundojnë aktivitetet e nisura para përfundimit të vlefshmërisë të saj. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, palën tjetër. Merrëveshja përgatitet në tre kopje, nga të cilat dy i mbeten FSHN-së dhe një ofruesit të praktikës.

Neni 3 Përshkrimi i aktivitetit

Iniciativat me interes të përbashkët do të implementohen kryesisht nëpërmjet:

- Ofrim i praktikave profesionale
- Ofrim i trajnimeve
- Ofrim i kurseve plotësuese.

Neni 4 Miratimi i praktikave/intershipeve


Për zhvillimin e praktikave/intershipeve çdo student duhet të pajiset me miratimin nga ana e institucionit, në të cilën përcaktohet periudha e kryerjes së saj. Në çdo rast miratimi do të jepet me kushtin e respektimit të procesit mësimor.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi u realizua sot, më datë 6/4/2022.

PËR

**FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS
UNIVERSITETI I TIRANES**

**DEKANI
PROF. DR. SPIRO DRUSHKU**



**INSTITUCION:
MENTE.AL**

**PËRFAQËSUESI:
DETION ALIAJ**

DETION ALIAJ

MARRËVESHJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
UNIVERSITETI I TIRANES

Nr. 1466 Prot.

Dt. 02.09.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

BERAT

Nr. 1339 Prot.

MARRËVESHJE

MBI

“REALIZIMIN E PRAKTIKAVE / TRAJNIMEVE MËSIMORE”

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), Universiteti i Tiranës, i cili është autoritet kompetent për qëllimin e Marrëveshjes, përfaqësuar nga **Dekani Prof. Dr. Spiro Drushku**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë dhe **AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, BERAT** përfaqësuar nga **Drejtori Fatlli Adilaj**

Nisur nga:

Interesi dhe dëshira e mirë e të dy institucioneve për të bashkëpunuar me njëri tjetrin me qëllim ofrim për studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës praktikim dhe trajnim sipas nevojave të tregut të punës. Nëpërmjet praktikave dhe trajnimeve profesionale studentët do të krijojnë mundësi për të marrë eksperiencë pune, të zhvillojnë dhe të zgjerojnë dijet e fituara në shkollë si dhe të afirmohen dhe të rritin mundësitë për punësim. Institucioni që do të ofrojë praktikat ose trajnimin do të krijojë mundësinë e njohjes dhe vlerësimin e kandidatëve për të punësuar në të ardhmen.

Në mbështetje të:

Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10 171 Datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.

Bien dakort mbi Marrëveshjen si më poshtë:

Marreveshje midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës - UT dhe AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, BERAT

Neni 1

Objekti i kontratës

Kjo Marrëveshje do të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve në realizimin e praktikave/trajnimeve mësimore.

Neni 2

Kohezgjatja dhe rinovimi

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për tre vjet nga data e nënshkrimit të saj dhe është e rinovueshme vetëm nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet palëve. Pavarësisht përfundimit të kohëzgjatjes të kësaj Marrëveshjeje, palët impenjohen të përfundojnë aktivitetet e nisura para përfundimit të vlefshmërisë të saj. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, palën tjetër.

Neni 3

Përshkrimi i aktivitetit

Iniciativat me interes të përbashkët do të implementohen kryesisht nëpërmjet:

- Ofrim i praktikave profesionale
- Ofrim i trajnimeve
- Ofrim i kurseve plotësuese.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi u realizua sot, më datë 01 / 09 / 2022.

PËR

**FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS
UNIVERSITETI I TIRANES**

DEKANI

PROF. DR. SPIRO DRUSHKU

PËR

AUTORITETI KOMBETAR I USHQIMIT, BERAT

DREJTORI

FATLLI ADILAJ

